

AKT- THEMELIMI

I SHOQËRISË TREGËTARE ME PËRGJËGJËSI TË

KUFIZUAR

“ OVA Dental ” Sh.p.k.

Në datë 05 / 01 /2025 ortaket; te themeloje shoqërine tregëtare “OVA Dental” Sh.p.k. për të zhvilluar aktivitetet tregëtar në fusha të ndryshme, si më poshtë:

Në bazë të legjislacionit shqiptar eshte vendosur me vullnetin e lirë dhe të plotë, marrëveshja për themelimin e shoqërisë tregtare private, me përgjegjësi të kufizuar, të emërtuar “**OVA Dental**” Sh.p.k. e cila do të rregullohet në mbështetje të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”; ligji Nr.9723 date 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar , si dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi dhe normave që vijnë:

Neni 1

Te themelojë një shoqëri tregëtare me përgjegjësi të kufizuar e quajtur “**OVA Dental** Sh.p.k. “**OVA Dental**” Sh.p.k. është një subjekt juridik Shqiptar, të cilit i lind e drejta të ushtrijë aktivitetin që nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB). Shoqëria “**OVA Dental**” Sh.p.k. zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar dhe me aktet e themelimit të saj.

Neni 2

Shoqëria do të jetë e formës së Shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar dhe përballon humbjet sipas ligjit.

Neni 3

Objekti i aktivitetit ekonomik të shoqërisë do të jetë:

- Klinike dentare
- Klinikë stomatologjike, implantologji dhe kirurgji orale, imazheri dentare, si dhe veprimtari të tjera në fushën e shërbimeve stomatologjike e dentare.
- Organizimi dhe promovimi i turizmit dentar, duke përfshirë ndërmjetësimin midis klientëve tanë dhe klinikave të licensuara dentare e stomatologjike
-

Neni 4

- Shoqëria “**OVA Dental**” Sh.p.k. ka selinë e saj në adresën: “Lake View residence, Godina C, Kati 10”

Neni 5

Kapitali themeltar i Shoqërisë “**OVA Dental.**” Sh.p.k.do të jetë **500,000 leke** dhe është i përbërë nga shuma në të holla e derdhur nga ortakët.

Neni 6

Kuota e pjesmarrjes eshte si më poshtë:

1-Xheisilda Hoxha-1

Neni 7

Kohëzgjatja e shoqërisë “**OVA Dental**” Sh.p.k. do të jetë me afat të pacaktuar. Ajo mund tëshpërbëhet në cdo kohë me vendim tëasamblesë së ortakëve.

Neni 8

I gjithë kapitali i vënë ortaku themelues është tërësisht dhe plotësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm nga ana e tyre.

Neni 9

Në librin e llogarisë që do të krijohet nëShoqërinë Tregëtare do të shënohet dhe kapitali i derdhur nga ortaku.Rritja e kapitalit themelor të shoqërisë nuk është e kufizuar.

Neni 10

Të ardhurat e realizuara nga shoqëria do të ndahen per ortakun sipas kuotes të pjesmarrjes në kapitalin themeltar si dhe nëpërmjet akteve të tjera noteriale apo kontratave të punës që ata do të realizojnë, pasi të jetë lënë një shumë mënjane të paktën sa një e njëzeta e tij e cila destinohet për formimin e fondit rezervë.

Neni 11

Ne kohën e prishjes së shoqërisë ose të përfundimit të afatit, kur nuk ka zgjatje afati kapitali i shoqërisë pasi të hiqen debitë e saj do ti ndahet ortakut sipas kuotes të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar.

Neni 12

Fitimi i realizuar nga veprimtaria ekonomike e shoqërisë, pas shlyerjes së detyrimeve ligjore dhe ato që kanë lindur me të tretët, është plotësisht i transferueshëm dhe për tu depozituar në një nga Bankat Shqiptare, ose për tu përdorur sipas nevojave të ortakëve të shoqërisë.

Neni 13

Ortaku ka këto të drejta dhe detyra themelore:

- të derdhi kuotën e kapitalit bazë sikundër është përcaktuar në nenin 6,
- të marri pjesë në drejtimin e shoqërisë,
- të tërheqi fitimin e realizuar,
- të tërheqi aktivin resultant nga bilanci i likuidimit në rast të pushimit të aktivitetit të shoqërisë,
- të ruajë sekretin e aktivitetit të shoqërisë,
- të impenjohet për arritjen e objektivave të shoqërisë.

Neni 14

Organet e shoqërisë “**OVA Dental**” Sh.p.k. janë:

- Asambleja e Pergjithshme
- Administratori i shoqërisë.

Modalitetet e formimit dhe funksionimit të tyre do të përcaktohen në statutin e shoqërisë
Administrator i shoqërisë do të jetë **Znj Xheisilda Hoxhapër** një afat 5 vjecar.

Neni 15

Shoqëria tregëtare private “**OVA Dental**” Sh.p.k. është person juridik shqipëtar dhe do të ushtrojë veprimtarinë e saj ekonomike private në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi dhe vecanërisht ligji 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” si dhe ligji Nr.9723 date 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, të K. Civil si dhe të akteve ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të tyre.

Neni 16

Marrëdhëniet e punësimit në shoqëri do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit, që lidhet midis palëve në mbështetje të ligjit Nr.7961, date 12.07.1995 (KODIT TË PUNËS), si dhe akteve të tjera në zbatim të tij.

Neni 17

Mosmarrëveshjet e mundëshme që mund të lindin gjatë interpretimit apo zbatimit të kësaj kontrate palët do ti zgjidhin në rrugë miqësore, në të kundërt kompetencat për zgjidhjen e konfliktit i kalon Gjykatës së Rrethit Gjyqësor përkatës.

Neni 18

Për sa nuk përshkruhet në këtë kontratë themelimi do të aplikohen nenet e statudit të shoqërisë dhe dispozitat e legjislacionit shqipëtar.

Neni 19

Ky Akt-themelimi është përpiluar në tre kopje origjinale.

Datë 05.01.2025

ORTAKET THEMELUES

Xheisilda Hoxha

A handwritten signature in blue ink, consisting of a large, loopy 'X' followed by 'heisilda' and 'Hoxha' in a cursive script.